


# TRANSPARENCA NË PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR PERIUDHËN 2021-2024

ON



OFF

**Titulli:** TRANSPARENCA NË PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TË ENERGJISË  
ELEKTRIKE PËR PERIUDHËN 2021-2024

**Autori:** Naim Bujupi

**Publikuar:** Tetor, 2024

Projekti “Mbështetje për Shoqërinë Civile për të Ritur Mbikëqyrjen Publike dhe Llogaridhënien e Institucioneve Publike të Kosovës” financohet nga Ministria e Punëve të Jashtme, Komonuelthit dhe Zhvillimit të Mbretërisë së Bashkuar përmes Ambasadës Britanike në Prishtinë.

Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi vetëm e Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS), Instituti GAP (GAP) dhe Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP) dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Ministrisë së Punëve të Jashtme, Komonuelthit dhe Zhvillimit të Mbretërisë së Bashkuar.

# PËRMBAJTJA

HYRJE	<b>4</b>
KORNIZA LIGJORE PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE	<b>5</b>
PROCESI I PËRCAKTIMIT TË TARIFAVE PËR PERIUDHËN 2021-2024	<b>7</b>
PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME	<b>18</b>

# HYRJE

Qëllimi i këtij punimi është të analizojë shkallën e transparencës në procesin e përcaktimit të tarifave të energjisë elektrike në Kosovë për periudhën 2021-2024. Gjatë kësaj periudhe, vendosja e tarifave është përballur me sfida të rëndësishme, për shkak të krizës energjetike globale dhe ndryshimeve në sektorin energjetik të Kosovës. Ky punim synon të hetojë sesi janë përcaktuar tarifat nga autoritetet përgjegjëse, si ZRRE, me një fokus të veçantë mbi proceset e konsultimit publik, qasjen në informacion dhe mekanizmat e raportimit. Përmes këtij vlerësimi, synohet të kuptohet nëse këto procese kanë qenë të hapura dhe të drejta, si dhe nëse konsumatorët kanë pasur mundësi të marrin pjesë dhe të informohen në mënyrë të duhur.

Transparenca është një nga parimet themelore për të siguruar drejtësi dhe përgjegjshmëri në procesin e përcaktimit të tarifave të energjisë elektrike. Një proces transparent kontribuon në krijimin e besimit midis konsumatorëve dhe autoriteteve si ZRRE, të cilat marrin vendime për tarifat, si dhe midis konsumatorëve dhe kompanive të furnizimit me energji, në këtë rast KESCO, që vepron si Furnizues i Shërbimit Universal (FSHU). Kur vendimet për tarifat mbështeten në një proces të hapur, ku informimi është i qasshëm dhe konsultimet me palët e interesuara janë efektive, konsumatorët ndihen më të sigurt se tarifat janë vendosur në mënyrë të drejtë dhe të bazuar në të dhëna të qarta ekonomike dhe operative. Në të kundërtën, mungesa e transparencës mund të shkaktojë pasiguri, dyshime dhe pakënaqësi publike, veçanërisht kur tarifat rriten për shkak të faktorëve të jashtëm apo krizave energjetike, siç ka ndodhur në Kosovë gjatë periudhës 2021-2024.

Sektori i energjisë në Kosovë ka përballuar sfida të konsiderueshme gjatë viteve të fundit. Termocentralet e vjetruara të Kosovës, të cilat mbulojnë rreth 80% të konsumit vendor, kanë hasur vazhdimisht probleme teknike dhe mjedisore. Në të njëjtën kohë, kërkesa për energji ka qenë në rritje, duke e bërë vendin gjithnjë e më të varur nga importet e energjisë elektrike, sidomos gjatë periudhave kur kapacitetet e brendshme kanë qenë të pamjaftueshme për të përmbushur nevojat, veçanërisht gjatë dimrit. Kriza globale e energjisë në vitin 2022, e shkaktuar nga çrregullimet në tregun ndërkombëtar të gazit dhe naftës, e ka përkeqësuar më tej situatën, duke çuar në rritje të çmimeve të energjisë në tregjet ndërkombëtare.

Në këtë kontekst, përcaktimi i tarifave për energjinë elektrike në Kosovë gjatë periudhës 2021-2024 ka marrë një rëndësi të veçantë. Duke qenë se tarifa është një faktor kyç për mirëqenien e ekonomisë familjare dhe për konkurrencën e sektorit privat, është thelbësore që procesi i vendosjes së tyre të jetë i qartë, i hapur dhe transparent. Rritjet e tarifave, të shkaktuara nga kostot e larta të importit, investimet për përmirësimin e infrastrukturës energjetike dhe integrimin e burimeve të ripërtëritshme, kanë pasur ndikim të drejtpërdrejtë te konsumatorët, duke nxitur debat publik për mënyrën sesi është menaxhuar ky proces nga ZRRE dhe institucionet përkatëse. Kjo është veçanërisht e rëndësishme kur bëhet fjalë për përcaktimin e bllok-tarifave për ekonomitë familjare, të cilat kanë pasur një ndikim të madh në buxhetet e familjeve dhe në perceptimin e drejtësisë në procesin tarifor.

# KORNIZA LIGJORE PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE

Zyra e Rregullatorit për Energjinë (ZRRE) luan një rol kyç në përcaktimin dhe rregullimin e tarifave të energjisë elektrike në Kosovë. Si një institucion i pavarur, ZRRE ka për detyrë të mbikëqyrë dhe të sigurojë që procesi i përcaktimit të tarifave të jetë i drejtë, transparent dhe i bazuar në kostot reale të furnizimit me energji elektrike. Përmes këtij procesi, ZRRE garanton që tarifat jo vetëm të pasqyrojnë realitetet ekonomike dhe nevojat për investime në sektorin e energjisë, por edhe të marrin parasysh interesat e të gjitha palëve të përfshira, përfshirë konsumatorët dhe furnizuesit me energji. Kjo qasje siguron që tarifat të jenë të balancuara dhe të përbalueshme, duke mundësuar një zhvillim të qëndrueshëm të sektorit energjetik në Kosovë.

Roli i ZRRE-së në përcaktimin e tarifave përfshin [1]:

- Analizën e kostove të operatorëve të shpërndarjes dhe furnizimit me energji;
- Shqyrtimin dhe aprovimin e propozimeve tarifore nga operatorët e licencuar;
- Konsultimet publike me palët e interesuara për çdo ndryshim tarifor;
- Miratimin e tarifave për konsumatorët, duke përfshirë konsumatorët familjarë dhe komercialë;
- Monitorimin e tregut të energjisë dhe mbikëqyrjen e zbatimit të tarifave të aprovuara;

Kjo qasje siguron një proces transparent dhe pjesëmarrës, duke lejuar publikun dhe aktorët e ndryshëm të kenë akses në informacionet tarifore përmes raportimeve të ZRRE-së dhe konsultimeve publike të rregullta. Sipas legjislacionit në fuqi, ZRRE përditëson tarifat në intervale të rregullta dhe të jashtëzakonshme, për të pasqyruar ndryshimet në tregun e energjisë dhe kostot operacionale të ndërmarrjeve energjetike.

ZRRE për vendosjen e tarifave bazohet në dispozitat e Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084), veçanërisht nenet 9, 15, 25, 26, 46, 47 dhe 48, si dhe në Ligjin për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085). Gjithashtu, ZRRE përdor legjislacionin sekondar për përcaktimin e të hyrave të Furnizuesit me Shërbim Universal (FSHU) dhe metodologjinë për strukturën tarifore të miratuar nga Bordi i ZRRE-së.

Sipas Nenit 9 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, Bordi i Rregullatorit është përgjegjës për miratimin e politikave rregullative dhe operacionale, duke mbikëqyrur zbatimin e buxhetit dhe funksionimin e përgjithshëm të institucionit. Një nga detyrat kryesore të Bordit është përgatitja e rregulloreve që përcaktojnë mënyrën e organizimit dhe procedurat e punësimit, si dhe miratimi i Kodit të Etikës dhe akteve nënligjore që sigurojnë një menaxhim efikas dhe të drejtë të aktiviteteve të Rregullatorit. Sipas Nenit 15, Rregullatori ka një rol të rëndësishëm në garantimin e funksionimit të drejtë dhe efektiv të tregut të energjisë në Kosovë. Ai ka për detyrë të miratojë metodologjitë për llogaritjen e kushteve të lidhjes në rrjetet kombëtare dhe të përcaktojë tarifat për transmetim dhe shpërndarje të energjisë elektrike. Këto tarifa duhet të jenë të arsyeshme dhe të mbështesin investimet në infrastrukturë, duke siguruar një sistem energjetik të qëndrueshëm dhe të zhvilluar.

gjithashtu siguron shërbime balancimi për të ruajtur stabilitetin e rrjetit energjetik dhe monitoron sigurinë e furnizimit me energji elektrike, energji termike dhe gaz natyror.

Neni 47 i Ligjit përcakton se ZRRE ka për detyrë të hartojë dhe miratojë metodologjitë për përcaktimin e tarifave të rregulluara për furnizimin me energji elektrike. Ky proces përfshin konsultime publike, me qëllim sigurimin e transparencës dhe përfshirjes aktive të palëve të interesuara. Metodologjitë e tarifave duhet të pasqyrojnë kostot reale të ofrimit të shërbimeve, duke u bazuar në parimet e arsyeshmërisë, mosdiskriminimit dhe transparencës. Metodologjitë duhet të jenë të drejta dhe të bazuara në shpenzime të arsyeshme, duke përfshirë një kthim të arsyeshëm për investimet e bëra. Po ashtu, ato duhet të nxisin përmirësimin e cilësisë së shërbimeve dhe efikasitetin operacional, duke lejuar që tarifat të vendosen në bazë të performancës. Në përcaktimin e tyre, duhet të merren parasysh aspektet e mbrojtjes mjedisore, për të garantuar që mekanizmat e çmimeve të trajtohen në mënyrë të barabartë për të gjithë konsumatorët, duke siguruar një qasje të drejtë dhe të qëndrueshme për energjinë.

Neni 25 përcakton procedurat e seancave të Bordit të Rregullatorit, duke siguruar transparencë dhe qasje të publikut në vendimmarrje. Seancat janë të hapura për publikun, përveç rasteve kur Bordi vendos që mbledhjet të jenë të mbyllura për arsye konfidencialiteti. Vendimet miratohen me një kuorum prej të paktën dy të tretave të anëtarëve dhe regjistrohen në procesverbal. Roli i ZRRE në vendosjen e tarifave është kyç për një treg të drejtë dhe funksional të energjisë. Mbështetur në legjislacionin përkatës dhe procedura të qarta, ZRRE siguron që tarifat të jenë të arsyeshme dhe të mbështesin zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit, duke mbrojtur interesat e konsumatorëve dhe garantuar furnizim të qëndrueshëm me energji.

---

[1] <https://www.ero-ks.org/zrre/index.php/sq/legjislacioni/ligjet> <https://www.ero-ks.org/zrre/sq/legjislacioni/udhezimet>  
[https://corrwatch.org/wp-content/uploads/2023/03/ETR\\_raporti-tematik-INDEP-ALB-1.pdf](https://corrwatch.org/wp-content/uploads/2023/03/ETR_raporti-tematik-INDEP-ALB-1.pdf)

# PROCESI I PËRCAKTIMIT TË TARIFAVE PËR PERIUDHËN 2021-2024

ZRRE-ja ka kryer konsultime publike si pjesë e procesit të përcaktimit të tarifave, në përputhje me ligjin për sektorin e energjisë dhe politikat e transparencës. Gjatë këtyre konsultimeve, publiku dhe palët e interesuara kanë pasur mundësinë të japin komentet e tyre në lidhje me propozimet tarifore të paraqitura. Konsultimet kanë përfshirë publikimin e dokumenteve draft, mbajtjen e sesioneve dëgjimore dhe mbledhjen e reagimeve nga konsumatorët, furnizuesit dhe operatorët e licencuar. Pjesëmarrja aktive e publikut ka ndihmuar në rritjen e transparencës dhe pranueshmërisë së vendimeve tarifore. [2]

Për përcaktimin e tarifave, ZRRE-ja ka ndjekur një metodologji të bazuar në kosto. Ky proces ka marrë parasysh disa faktorë, duke përfshirë:

- *Kostot operative dhe mirëmbajtjen e sistemeve të rrjetit dhe furnizimit;*
- *Investimet kapitale në infrastrukturën energjetike të bëra nga operatorët e licencuar si KOSTT dhe sistemi i distribucionit;*
- *Inflacionin dhe ndikimet e tjera makroekonomike që prekin tregun e energjisë;*
- *Kostot e importit të energjisë elektrike, të cilat kanë pasur një ndikim të madh në tarifat e konsumatorëve;*

ZRRE-ja ka përdorur gjithashtu një qasje të balancuar, që mbron interesat e konsumatorëve dhe operatorëve, duke siguruar një sistem të qëndrueshëm dhe të besueshëm furnizimi me energji. Vlen të përmendet se tarifat e energjisë elektrike kanë pësuar disa ndryshime të rëndësishme, të cilat janë rezultat i faktorëve të ndryshëm ndikues. Këto përfshijnë:

- *Rritjen e koston së importit të energjisë elektrike, për shkak të luhatjeve në tregjet ndërkombëtare, si pasojë e luftës në Ukrainë dhe nevojës për të mbuluar kërkesën që tejkalon prodhimin vendas;*
- *Integrimin e burimeve të rinovueshme në sistemin e energjisë elektrike, ku janë bërë përpjekje për të stimuluar përdorimin e energjisë së gjelbër. Kjo ka ndikuar në tarifat për shkak të kostove të investimeve dhe mbështetjes për këto burime, veçanërisht me hyrjen në operim të centraleve me erë, për të cilat janë aplikuar tarifat nxitëse "feed-in";*
- *Ndikimet e krizës energjetike globale, që kanë sjellë sfida të paparashikuara dhe kanë kërkuar përshtatje të tarifave për të siguruar stabilitetin e furnizimit, si dhe mbrojtjen e konsumatorëve të cenueshëm;*

---

[2] <https://www.ero-ks.org/zrre/sq/proceset-e-shqyrtimeve-tarifore> <https://www.ero-ks.org/zrre/sq/publikimet/raportet-vjetore>

Më poshtë është paraqitur një matricë e konsultimeve publike, ku përfshihen dokumentet relevante të gjitha palëve të interesuara dhe komentet e tyre në lidhje me transparencën e procesit tarifor:

DOKUMENTET E PUBLIKUARA	KOMENTE
<p><i>Viti 2021:</i></p> <p><i>Raport përfundimtar për Të Hyrat e Lejuara Maksimale të Furnizuesit me Shërbim Universal, Përgjigjet ndaj Komenteve</i></p> <p><i>Raport përfundimtar për Të Hyrat e Lejuara Maksimale të OSSH-së, Përgjigjet ndaj Komenteve</i></p> <p><i>Raport përfundimtar për Të Hyrat e Lejuara Maksimale të OST/OT, Përgjigjet ndaj Komenteve</i></p> <p><i>Komentet - KOSTT</i></p> <p><i>Komentet - KEDS</i></p> <p><i>Komentet - KESCO</i></p> <p><i>Komentet – Ministria e Ekonomisë</i></p> <p><i>Njoftimi për hapjen e konsultimit publik</i></p> <p><i>FSHU-Raport_Konsultativ per MAR 2021</i></p> <p><i>KOSTT-Raport_Konsultativ per MAR 2021</i></p> <p><i>OSSH-Raport_Konsultativ per MAR 2021</i></p> <p><i>Aplikacioni KOSTT</i></p> <p><i>Aplikacioni KEDS</i></p> <p><i>Aplikacioni KESCO/FSHU</i></p>	<p><i>Në vitin 2021, procesi i shqyrtimit tarifor nga Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) u vonua për shkak të mungesës së Bordit funksional. Bordi u plotësua më 2 gusht 2021 me zgjedhjen e dy anëtarëve dhe kryesuesit nga Parlamenti i Republikës së Kosovës. Pas kësaj, ZRRE rifilloi procesin e shqyrtimit tarifor, duke përgatitur raportin konsultativ në mars 2021, i cili u hodh për konsultim publik më 24 gusht 2021. Ky raport përfshinte vlerësimet fillestare të ZRRE-së lidhur me aplikacionet e licencuarve për kërkesat e të hyrave për vitin tarifor 2021, të bazuara në të dhënat e vitit 2020 dhe parashikimet për vitin 2021.</i></p> <p><i>ZRRE veprimi në përputhje me dispozitat e Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084), duke ndjekur udhëzimet specifike të neneve 9, 15, 25, 26, 46, 47 dhe 48, si dhe Ligjin për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085). Përveç këtyre, ZRRE mbështeti procesin e vendosjes së tarifave në legjislacionin sekondar për përcaktimin e të hyrave të Furnizuesit me Shërbim Universal (FSHU), dhe në metodologjinë për strukturën tarifore të miratuar nga Bordi i ZRRE-së.</i></p> <p><i>Më 7 tetor 2021, ZRRE miratoi të hyrat e lejuara maksimale për Furnizuesin me Shërbim Universal (FSHU/KESCO SH.A.), dhe më 14 tetor pranoi propozimin e KESCO-s për strukturën tarifore. Ky vendim, i marrë në përputhje me Rregullën për të Hyrat e FSHU-së dhe metodologjinë për strukturën tarifore, reflektonte kostot e përgjithshme të furnizimit me energji elektrike për konsumatorët e furnizuar në kuadër të Furnizimit me Shërbim Universal, duke përfshirë kostot e energjisë me shumicë, rrjetet e transmetimit dhe shpërndarjes, si dhe shpenzimet direkte të FSHU-së.</i></p>



*Vendimi përfundimtar për tarifat me pakicë për konsumatorët u mor më 27 tetor 2021, pas një shqyrtimi të plotë të dokumentacionit dhe raporteve të konsultimit, të cilat përfshinin komente nga palët e interesuara dhe analizën përkatëse të kryer nga ZRRE. Procesi i shqyrtimit përfshiu gjithashtu një vlerësim të detajuar të kostove operative dhe të ardhurave të licencuarve, duke marrë parasysh kushtet e tregut dhe nevojat për investime në sektorin energjetik. Krahasuar me vitin 2020, në vitin 2021 nuk pati ndryshime tarifore, që do të thotë se të gjitha çmimet në të gjitha elementet tarifore mbetën të njëjta me ato të vitit 2020. Ky vendim u bazua në analizat e ZRRE-së, të cilat vlerësuan se kostot e furnizimit dhe shpërndarjes nuk justifikonin ndonjë ndryshim të çmimit për vitin 2021.*

## KONKLUZION

Transparenca e procesit të shqyrtimit tarifor shpesh varet nga përfshirja e gjerë e palëve të interesuara. Në këtë rast, duket se vetëm operatorët e licencuar dhe Ministria e Ekonomisë kanë dhënë komente me shkrim, ndërsa palë të tjera, si konsumatorët, nuk kanë kontribuar. Kjo ngre shqetësime rreth përfshirjes së plotë dhe përfaqësimit të interesave të ndryshme. Krijimi i një regjistri të qartë për komentet e marra dhe përgjigjet ndaj tyre është thelbësor për garantimin e transparencës. Në këtë rast, ZRRE ka publikuar përgjigjet e saj ndaj komenteve të palëve, duke treguar një nivel të lartë të transparencës. Konsultimi publik është hapur brenda afateve të parashikuara, që përbën një tregues pozitiv të transparencës. Megjithatë, duke marrë parasysh ndikimin e tarifave mbi konsumatorët, është e rëndësishme që të bëhet një njoftim më i gjerë përmes mediave. Kjo do të ndihmonte në rritjen e ndërgjegjësimit dhe interesimit të konsumatorëve për këtë proces, edhe nëse nuk ka ndryshime tarifore. Një komunikim më i mirë do të inkurajonte pjesëmarrjen aktive të konsumatorëve dhe do të siguronte që zëri i tyre të dëgjohej në këtë proces të rëndësishëm.

Shpërndarja e informacionit rreth procesit tarifor dhe qasja në dokumentet përkatëse nga publiku janë elemente të rëndësishme për rritjen e transparencës. Dokumentet e aplikacioneve tarifore kanë qenë lehtësisht të qasshme për publikun, gjë që ka ndikuar pozitivisht në besimin ndaj këtij procesi. Vonesat rregullative janë tejet problematike për sektorin energjetik, siç ishte rasti në vitin 2021, kur procesi i shqyrtimit tarifor nga ZRRE u përball me sfida të mëdha për shkak të mungesës së Bordit funksional. Kjo situatë ka vonuar miratimin e tarifave të energjisë, të cilat duhej të ishin aprovuar më së largu në fund të muajit mars, për të hyrë në fuqi më 1 prill 2021. Megjithatë, pas plotësimit të Bordit më 2 gusht 2021 me zgjedhjen e dy anëtarëve dhe kryesuesit nga Parlamenti i Republikës së Kosovës, tarifat u miratuan përfundimisht vetëm në fund të tetorit. Këto vonesa kanë pasur ndikim në sektorin energjetik, duke krijuar pasiguri për operatorët dhe konsumatorët.

Mungesa e tarifave të reja brenda afateve të përcaktuara krijon pasiguri financiare për kompanitë e rregulluara, të cilat varen nga miratimi i tarifave për të planifikuar buxhetin dhe investimet e ardhshme. Pa këto miratime në kohë, kompanitë përballen me vështirësi në menaxhimin e burimeve dhe sigurimin e financave të nevojshme për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e infrastrukturës. Vonesat në miratimin e tarifave ndikojnë gjithashtu negativisht në besimin e konsumatorëve ndaj institucioneve rregullatore dhe kompanive energjetike. Kësisoj, vonesa në miratimin e tarifave sjell një sërë sfidash për kompanitë e energjisë, konsumatorët dhe stabilitetin e përgjithshëm të sektorit. Për të shmangur situata të tilla në të ardhmen, është e domosdoshme që institucionet përgjegjëse të sigurojnë që ZRRE të mos mbetet pa kuorum të Bordit, duke garantuar kështu vazhdimësinë dhe efikasitetin e procesit rregullator. Kjo masë do të ndihmonte në parandalimin e vonesave të ngjashme dhe do të forconte besimin e palëve të interesuara në sistemin energjetik.

SHQYRTIMI I JASHTËZAKONSHËM TARIFOR (2021-2022)	KOMENTE
<p><i>Raport përfundimtar për Strukturën Tarifore - Përgjigje ndaj Komenteve</i></p> <p><i>Raporti përfundimtar për MAR- Përgjigje ndaj Komenteve</i></p> <p><i>Komentet e palëve të interesit ndaj Raporteve Konsultative të ZRRE-së</i></p> <p><i>Komentet e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë_shqip</i></p> <p><i>Komentet e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë_anglisht</i></p> <p><i>Komentet e Konsumatorëve Shqyrtimi i jashtëzakonshëm tarifor</i></p> <p><i>Komente_Zyra e Presidentes së Republikës së Kosovës</i></p> <p><i>INDEP_Komente ne Propozimin e ZRRE-se per tarifa te reja te energjise</i></p> <p><i>BGF - Komentet dhe rekomandimet për Shqyrtimin e Jashtëzakonshëm të Tarifave (2021-2022)</i></p> <p><i>Komentet e Shoqatës së Mullisëve të Kosovës</i></p> <p><i>Komentet e GP LVV për shqyrtimin e jashtëzakonshëm tarifor</i></p> <p><i>Komentet e LDK-ë në raportin konsultativ të ZRRE-së</i></p> <p><i>Komentet e AAK-së në raportin Konsultativ të ZRRE-së</i></p>	<p><i>Gjatë një procesi të jashtëzakonshëm tarifor, më 8 shkurt 2022, ZRRE miratoi tarifën e reja të energjisë elektrike për konsumatorët që përfitojnë furnizim me shërbim universal, duke rikthyer bllok-tarifat, të cilat ishin hequr në vitin 2017. Ky vendim erdhi si përgjigje ndaj krizës energjetike globale dhe rritjes së ndjeshme të çmimeve në tregjet ndërkombëtare.</i></p> <p><i>Ristrukturimi i tarifave u bë i nevojshëm për të shpërndarë më drejt kostot mes konsumatorëve dhe për të inkurajuar përdorimin e përgjegjshëm të energjisë elektrike, duke krijuar një balancë më të mirë mes furnizimit dhe kërkesës në kushte krize.</i></p> <p><i>Bllok-tarifat u rikthyen me qëllimin e uljes së konsumit të lartë të energjisë dhe për të mbrojtur konsumatorët që shpenzojnë më pak energji. Ndërkohë, qeveria miratoi një subvencion prej 90 milionë eurosh për të mbuluar kostot e larta të blerjes së energjisë dhe për të zvogëluar ndikimin financiar të konsumatorëve, veçanërisht për ata që konsumojnë deri në 800 kWh, duke bërë që këta konsumatorë të mos përballen me rritje të ndjeshme tarifore. Sipas strukturës së re, për konsumatorët familjarë me konsum deri në 800 kWh, tarifat do të mbeten të subvencionuara dhe nuk do të ketë rritje çmimi në krahasim me vitin 2021.</i></p> <p><i>Ndërsa për konsum mbi 800 kWh, tarifat janë përcaktuar si më poshtë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li><i>• 0.1252 €/kWh për energjinë e konsumuar gjatë tarifës së lartë;</i></li> <li><i>• 0.059 €/kWh për energjinë e konsumuar gjatë tarifës së ulët.</i></li> </ul> <p><i>Rikthimi i bllok-tarifave synon të balancojë konsumin dhe të sigurojë që kostot e rritura të furnizimit me energji të mos rëndojnë tej mase konsumatorët, veçanërisht gjatë krizës energjetike. Pas heqjes së bllok-tarifave në vitin 2017, u regjistrua një rritje e madhe e konsumit, e cila e ngarkoi rëndë rrjetin, duke vështirësuar sigurinë e furnizimit me energji elektrike.</i></p>

SHQYRTIMI I JASHTËZAKONSHËM TARIFOR (2021-2022)	KONKLuzion
<p><i>Komentet nga Ministria e Ekonomisë</i></p> <p><i>Komentet nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve</i></p> <p><i>KOSTT_ Komente ndaj Raportit Konsultativ për Shqyrtimin e Jashtëzakonshëm të të Hyrave Maksimale të Lejuara të Energjisë Elektrike për Operatorët e Rregulluar</i></p> <p><i>Komentet e FSHU ndaj Raportit Konsultativ ZRRE</i></p> <p><i>Komentet e OSSH ndaj Raportit Konsultativ të ZRRE</i></p> <p><i>Komentet në Raport Konsultativ_FUENTE Dynamics</i> <i>Raportet konsultative të ZRRE-së</i></p> <p><i>Raporti konsultativ për shqyrtim të jashtëzakonshëm të MAR</i></p> <p><i>Raport konsultative për strukturën tarifore</i></p> <p><i>Letra inicuese e Procesit të Shqyrtimit i Jashtëzakonshëm i Te Hyrave të Lejuara Maksimale për Operatorët e Rregulluar</i></p> <p><i>Aplikacioni i KOSTT për Shqyrtimin e Jashtëzakonshëm të të Hyrave të Lejuara Maksimale</i></p> <p><i>Aplikim për Shqyrtim të Jashtëzakonshëm të të Hyrave të Lejuara Maksimale për OSSh</i></p> <p><i>Aplikim për Shqyrtim të Jashtëzakonshëm të të Hyrave të Lejuara Maksimale për FShU</i></p>	<p><i>Procesi i jashtëzakonshëm tarifor i vitit 2022, i cili solli ndryshimin e strukturës tarifore për shkak të krizës globale të kostos së energjisë elektrike, tërhoqi një vëmendje të madhe nga palë të ndryshme të interesit. Pjesëmarrja e ministrive, partive politike, Zyrës së Presidencës, konsumatorëve, shoqërisë civile dhe Komunës së Obiliqit në raportin konsultativ të ZRRE-së tregon për një nivel të lartë të përfshirjes dhe transparencës në këtë proces. Kjo përfshirje e gjerë ishte thelbësore për të pasur një vendimmarrje të balancuar dhe për të adresuar shqetësimet e të gjitha palëve të prekura nga ndryshimet tarifore. Kriza globale energjetike kërkoi masa të menjëhershme dhe ristrukturimi i tarifave ishte një përgjigje e domosdoshme për të shpërndarë në mënyrë të drejtë kostot midis konsumatorëve. Përfshirja e konsumatorëve dhe institucioneve në procesin konsultativ ndihmoi në rritjen e besimit publik dhe në krijimin e një platforme për dialog të hapur dhe konstruktiv.</i></p> <p><i>Vlen të theksohet se ZRRE-ja ka dhënë përgjigje për komentet dhe sugjerimet e palëve të interesuara dhe i ka bërë ato publike. Kjo qasje e komunikimit dhe publikimi i përgjigjeve është një hap i rëndësishëm për të rritur transparencën dhe llogaridhënien në procesin tarifor. Përfshirja e gjerë e institucioneve dhe grupeve të ndryshme tregon për një përpjekje serioze për të përfshirë zërat e shumtë në vendimmarrje dhe për të zhvilluar një debat të hapur, të bazuar në interesin publik.</i></p> <p><i>Në aspektin e transparencës, ky proces mund të vlerësohet pozitivisht, pasi ka krijuar një platformë që u ka mundësuar të gjitha palëve të interesuara të japin mendimet e tyre dhe të jenë pjesë e procesit. Veçanërisht e dobishme ka qenë përfshirja e konsumatorëve në dhënien e komenteve, një qasje që në të kaluarën kishte munguar.</i></p>

SHQYRTIMI I JASHTËZAKONSHËM 2023	KOMENTE
<p><i>Raport përfundimtar për të Hyrat e Lejuara Maksimale për FSHU_Përgjigjet ndaj Komenteve</i></p> <p><i>Raport Konsultativ të Hyrat e Lejuara Maksimale (HLM) të Furnizuesit të Shërbimit Universal,</i></p> <p><i>Aplikim për Shqyrtimin e Jashtëzakonshëm për të Hyrat e Lejuara Maksimale të Furnizuesit me Shërbim Universal (FSHU)-2023</i></p> <p><i>Njoftim për Shqyrtim të Jashtëzakonshëm të Hyrave të Lejuara Maksimale për Operatorët e Rregulluar</i></p> <p><i>Kërkese për Shqyrtimin e Jashtëzakonshëm për të Hyrat e Lejuara Maksimale të Furnizuesit me Shërbim Universal (FSHU)</i></p> <p><i>Kërkese për Shqyrtimin e Jashtëzakonshëm për të Hyrat e Lejuara Maksimale të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH-ë)</i></p>	<p><i>Më 5 dhjetor 2022, Furnizuesi me Shërbim Universal (FSHU) dorëzoi një kërkesë për shqyrtim të jashtëzakonshëm pranë ZRRE-së. Kjo kërkesë u pasua me hapjen e shqyrtimit tarifar më 11 janar 2023, ku ZRRE-ja analizoi të dhënat e operatorëve të rregulluar dhe konstatoi se ishin plotësuar kushtet për një shqyrtim të tillë. Ky vendim u bazua kryesisht në mungesën e të hyrave të realizuara dhe rritjen e kostove të energjisë me shumicë, duke tejkaluar pragun e materialitetit të parashikuar në rregullat për të hyrat.</i></p> <p><i>Procesi i shqyrtimit të jashtëzakonshëm u zhvillua në përputhje me procedurat e përshtatjes së rregullt vjetore. ZRRE-ja mori parasysh ndikimet e vazhdueshme të ngjarjeve të jashtëzakonshme dhe, më 23 janar 2023, pranoi aplikacionin e FSHU-së për të hyrat e lejuara maksimale për vitin 2023. Më pas, më 16 shkurt 2023, ZRRE-ja publikoi raportin konsultativ për përshtatjen vjetore të këtyre të hyrave.</i></p> <p><i>Gjatë periudhës së konsultimit publik, ZRRE-ja pranoi komente nga disa palë të interesuara, përfshirë Korporatën Energjetike të Kosovës, Sindikatën e Pavarur Elektrokosova, KESCO, Qeverinë dhe Zyrën e Presidentes së Kosovës. Pas shqyrtimit të komenteve dhe analizimit të propozimeve të paraqitura, më 23 mars 2023, ZRRE-ja përmes vendimit V_1707_2023 aprovoi të hyrat e lejuara maksimale të FSHU-së për periudhën tarifore të vitit 2023, të cilat arrinin në 398,442,759 euro. Këto të hyra do të mblihdeshin përmes tarifave me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët e rregulluar.</i></p> <p><i>FSHU dorëzoi propozimin për tarifën me pakicë më 27 mars 2023, bazuar në vendimin e ZRRE-së për të hyrat e lejuara. Pas analizimit të këtij propozimi, ZRRE-ja konstatoi se ai nuk reflektonte saktësisht kostot e shërbimit dhe mund të krijonte ndërsuvencionim ndërmjet grupeve tarifore. Gjithashtu, FSHU nuk ofroi argumente dhe të dhëna të mjaftueshme analitike për justifikimin e propozimit të saj.</i></p>

	<p>Për këtë arsye, ZRRE-ja ri-kalkuloi tarifat në përputhje me rregullat e përcaktuara dhe miratoi tarifat e reja me pakicë, të cilat mbulonin plotësisht kostot e furnizimit, përfshirë kostot e energjisë elektrike me shumicë, kostot e rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes, si dhe kostot direkte të FSHU-së. Këto tarifa u ndanë sipas grupeve tarifore, në përputhje me dispozitat ligjore, duke siguruar që secili grup tarifor të mbulonte kostot e veta. Në krahasim me tarifat e viteve 2020, 2021 dhe 2022, tarifat e miratuara për vitin 2023 më 30 mars shfaqën një rritje të njëtrajtshme prej 15% për të gjitha elementet tarifore, duke përfaqësuar një rritje të konsiderueshme.</p>
--	--

## KONKLUZION

Komentet e paraqitura nga palët e interesuara dhe përgjigjet e ZRRE-së janë publikuar në faqen zyrtare të institucionit, duke siguruar transparencë në procesin tarifor. Edhe pse ndryshimet nga vlerësimi fillestar nuk kanë qenë të ndjeshme, ZRRE ka marrë në konsideratë të gjitha komentet e dorëzuara, duke reflektuar përkushtimin e saj për të përfshirë të gjithë aktorët në këtë proces të rëndësishëm. Në vlerësimin përfundimtar, ZRRE ka konfirmuar që vlerësimi fillestar ka qenë kryesisht i saktë dhe i bazuar në të dhënat reale dhe të parashikuara, ndërsa komentet e palëve të interesuara janë analizuar me kujdes. Ndryshimet e propozuara nuk sollën modifikime të mëdha në të hyrat e lejuara, por ky proces konsultativ ka kontribuar në ruajtjen e një komunikimi të hapur mes ZRRE-së dhe palëve të përfshira.

Më 2 prill 2024, ZRRE vendosi për tarifat e energjisë elektrike që do të mbulojnë periudhën njëvjeçare nga 1 prill 2024 deri më 31 mars 2025. Këto tarifa janë rezultat i një procesi të gjatë analizash dhe konsultimesh, me qëllim që të mbrohen interesat e konsumatorëve dhe të sigurohet qëndrueshmëria financiare e sektorit të energjisë. Vendimi pasqyron balancimin e kostove reale të furnizimit me energji dhe nevojën për investime të qëndrueshme në infrastrukturën energjetike. Ky vendim gjithashtu synon të shmangë ndërsuvencionimin ndërmjet grupeve të ndryshme tarifore, duke siguruar drejtësi në përballimin e kostove për të gjithë konsumatorët.



SHQYRTIMI I JASHTËZAKONSHËM 2024	KOMENTE
<p><i>Raport përfundimtar për të Hyrat e Lejuara Maksimale per OST_OT_Përgjigjet ndaj Komenteve</i></p> <p><i>Raport përfundimtar për të Hyrat e Lejuara Maksimale per OSSH_Përgjigjet ndaj Komenteve</i></p> <p><i>Raport përfundimtar për të Hyrat e Lejuara Maksimale per FSHU_Përgjigjet ndaj Komenteve</i></p> <p><i>Komentet e KEK Sh.A- Raportet Konsultative</i></p> <p><i>Komentet e KOSTT Sh.A- Raporti Konsultativ për HLM</i></p> <p><i>Komentet e KEDS Sh.A- Raporti Konsultativ për HLM</i></p> <p><i>Komentet e FSHU- Raporti Konsultativ për HLM</i></p> <p><i>Komentet e INDEP- Raportet Konsultative për HLM</i></p> <p><i>Raport Konsultativ për të Hyrat e Lejuara Maksimale (HLM) të Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) për vitin 2024</i></p> <p><i>Raport Konsultativ për të Hyrat e Lejuara Maksimale (HLM) të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) për vitin 2024</i></p> <p><i>Raport Konsultativ të Hyrat e Lejuara Maksimale (HLM) të Furnizuesit të Shërbimit Universal për vitin 2024</i></p> <p><i>Aplikim për të Hyrat e Lejuara Maksimale për Furnizuesin me Shërbim Universal (FSHU)-2024</i></p>	<p><i>Më 12 dhjetor 2023, ZRRE-ja ka iniciuar procesin e Azhurnimeve Vjetore të të Hyrave dhe Tarifave për Operatorët e Rregulluar, duke përfshirë Furnizuesin me Shërbim Universal (FSHU). Ky proces ka për qëllim përcaktimin e të hyrave të lejuara maksimale për vitin tarifor 2024, që mbulon periudhën nga 1 prill 2024 deri më 31 mars 2025. Më 22 janar 2024, ZRRE-ja pranoi aplikacionin e FSHU-së për përcaktimin e të Hyrave të Lejuara Maksimale për vitin 2024. Pas pranimit të aplikacionit, më 6 shkurt 2024, ZRRE-ja publikoi Raportin Konsultativ për përshtatjet vjetore të këtyre të hyrave, duke hapur një periudhë konsultimi publik për palët e interesuara. Gjatë kësaj periudhe, palët e interesuara kishin mundësinë të paraqisnin komentet dhe sugjerimet e tyre brenda një periudhe dyjavore, duke marrë pjesë aktive në procesin e rregullimit tarifor për vitin 2024. Kjo periudhë konsultimi siguron transparencë dhe përfshirje në procesin vendimmarrës.</i></p> <p><i>Më 21 shkurt 2024, ZRRE-ja pranoi komentet nga FSHU dhe palët e interesuara në lidhje me vlerësimin fillestar të të Hyrave të Lejuara Maksimale. Në raportin përfundimtar, ZRRE-ja mori parasysh këto komente dhe përditësoi të dhënat në bazë të informacionit të ri të ofruar. Më 22 mars 2024, me vendimin V_1924_2024, ZRRE-ja aprovoi të Hyrat e Lejuara Maksimale për FSHU-në për vitin tarifor 2024. Pas këtij vendimi, më 28 mars 2024, ZRRE-ja pranoi propozimin për tarifatat me pakicë nga FSHU, të cilat u kalkuluan sipas metodologjisë për strukturën tarifore, bazuar në Rregullën ZRRE/Nr.15/2017.</i></p> <p><i>Këto tarifa reflektojnë kostot reale të furnizimit me energji elektrike për konsumatorët e Shërbimit Universal, duke përfshirë kostot e energjisë me shumicë, kostot e rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes, si dhe kostot direkte të FSHU-së. Gjatë periudhës së konsultimit publik, ZRRE-ja pranoi komente nga disa palë të rëndësishme, duke përfshirë Korporatën Energjetike të Kosovës, Institutin për Politika Zhvillimore dhe FSHU (KESCO), të cilat kontribuan në përfundimin e procesit tarifor.</i></p>

*Aplikim për të Hyrat e Lejuara  
Maksimale për Operatorin e Sistemit të  
Shpërndarjes (OSSH)-2024*

*Aplikim për të Hyrat e Lejuara  
Maksimale për Operator Sistemi,  
Transmisioni dhe Tregu (OSTT)-2024*

*Dokument inicues - Azhurnimet vjetore  
të të hyrave dhe tarifave për OST-OT,  
OSSH dhe FSHU*

Komentet e paraqitura dhe përgjigjet e ZRRE-së janë publikuar në faqen zyrtare të institucionit. Në vlerësimin përfundimtar, ndryshimet nga vlerësimi fillestar nuk kanë qenë të ndjeshme, por ZRRE-ja ka marrë në konsideratë të gjitha komentet e palëve të interesuara, duke treguar përkushtim për transparencë dhe përfshirje. Më 2 prill 2024, ZRRE-ja vendosi për tarifën e energjisë elektrike që mbulojnë periudhën njëvjeçare, nga 1 prill 2024 deri më 31 mars 2025, duke siguruar që këto tarifa të reflektojnë kostot reale të furnizimit dhe shpërndarjes.

## KONKLUZION

Një element i rëndësishëm i procesit tarifor për vitin 2024 ishte periudha e konsultimit publik. Edhe pse disa aktorë të rëndësishëm, si Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) dhe Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP), dhanë komentet e tyre, është shqetësuese që as Qeveria e Kosovës dhe as Zyra e Presidencës nuk kontribuuan në këtë proces me sugjerime apo komente. Gjithashtu, pjesëmarrja e konsumatorëve ishte e pamjaftueshme, duke ndjekur të njëjtën tendencë si vitin paraprak, ku zëri i tyre mungoi në mënyrë domethënëse. Në vendimin përfundimtar të ZRRE-së të datës 2 prill 2024, u përcaktua që tarifën për vitin 2024 do të jenë 3% më të ulëta për të gjitha elementet tarifore krahasuar me ato të vitit 2023. Për konsumatorët familjarë që konsumojnë më shumë se 800 kWh në muaj, ulja e tarifave ishte edhe më e ndjeshme, me një zbritje prej 8%. Ndërkohë, ndryshimet mes vlerësimit fillestar dhe raportit përfundimtar të ZRRE-së ishin të vogla, por të gjitha komentet e dorëzuara nga palët e interesuara u morën në shqyrtim dhe u reflektuan aty ku ishte e mundur.

Procesi tregoi një nivel të lartë transparence përmes hapjes së konsultimeve publike dhe publikimit të rezultateve të tyre. Megjithatë, mungesa e pjesëmarrjes së institucioneve kryesore dhe konsumatorëve ngre pyetje rreth efektivitetit të procesit të përfshirjes publike. Është e qartë se nevojitet një përpjekje më e madhe për të rritur ndërgjegjësimin dhe për të inkurajuar më shumë palë, veçanërisht konsumatorët, të marrin pjesë aktivisht në proceset e vendimmarrjes për çështje që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e tyre të përditshme.



# PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Gjatë periudhës 2021-2024, janë bërë përparime të dukshme në rritjen e transparencës në procesin e përcaktimit të tarifave të energjisë elektrike në Kosovë. Këto përmirësime kanë ndikuar në forcimin e besimit të konsumatorëve dhe të palëve të interesuara në këtë proces të rëndësishëm. Disa nga përmirësimet kryesore përfshijnë:

- Qasje e përmirësuar në dokumentet publike: Të gjitha rregulloret dhe dokumentet mbështetëse lidhur me tarifat janë bërë të qasshme për publikun. Kjo ka krijuar një hapësirë më të madhe për informimin e konsumatorëve dhe ka ndihmuar në rritjen e besueshmërisë së procesit tarifar, duke i dhënë mundësi publikut të ketë një pasqyrë më të qartë mbi mënyrën se si përcaktohen tarifat.
- Rritja e numrit të konsultimeve publike: Gjatë viteve të fundit ka pasur një rritje të ndjeshme të konsultimeve publike me palët e interesuara përpara ndryshimeve në tarifat e energjisë. Ky proces ka mundësuar një diskutim më të hapur dhe gjithëpërfshirës për të gjitha grupet e përfshira, duke lejuar që zërat e ndryshëm të dëgjohen dhe të merren parasysh.
- Transparencë mbi të dhënat financiare dhe operative: Të dhënat mbi kostot operative, të ardhurat dhe investimet e ndërmarrjeve të energjisë kanë qenë të qarta dhe të detajuara për publikun. Kjo transparencë është thelbësore për të siguruar që konsumatorët dhe aktorët e tjerë të kenë një kuptim të plotë të faktorëve që ndikojnë në çmimin e energjisë elektrike.

Megjithatë, pavarësisht përparimeve të konsiderueshme, mbetet ende hapësirë për përmirësim. Disa rekomandime kyçe për të rritur më tej transparencën dhe përfshirjen në procesin tarifar përfshijnë:

- Raportim më i rregullt dhe i detajuar nga ndërmarrjet energjetike: Për të rritur transparencën, ndërmarrjet e energjisë duhet të ofrojnë raporte më të shpeshta dhe të detajuara mbi performancën e tyre financiare dhe investimet që kanë bërë. Këto raporte duhet të përqendrohen veçanërisht tek ato investime që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në tarifat e konsumatorëve, në mënyrë që publiku të jetë më i informuar për arsyet e ndryshimeve tarifore.
- Konsultime më gjithëpërfshirëse: Konsultimet publike duhet të përfshijnë një gamë më të gjerë palësh të interesuara, duke përfshirë më shumë konsumatorë të thjeshtë dhe përfaqësues të grupeve më të cenueshme. Një shembull i mungesës së informimit të mjaftueshëm është rritja e tarifës fikse nga 1.74 € në vitin 2022 në 2 € në vitin 2023, një rritje prej 15%. Për këtë ndryshim nuk u dha një sqarim i qartë nga ZRRE-ja për arsyet e kësaj rritjeje, duke theksuar nevojën për një proces më të hapur konsultimi dhe informimi të publikut.

- Përfshirja aktive e konsumatorëve në çdo fazë të procesit: Një sistem i drejtë dhe i qëndrueshëm tarifash kërkon përfshirjen aktive të konsumatorëve në çdo fazë të procesit tarifor. Kjo do të ndihmonte në uljen e pakënaqësive dhe në rritjen e besimit të publikut ndaj institucioneve përgjegjëse. Kur konsumatorët janë më të informuar për mënyrën se si përcaktohen tarifat dhe për faktorët që ndikojnë në to, ata janë më të prirur të pranojnë ndryshimet tarifore që bazohen në një proces të drejtë dhe transparent.
- Rritja e ndërgjegjësimit për kursimin e energjisë: Kur konsumatorët kuptojnë strukturën e tarifave dhe ndikimin që kanë sjelljet e tyre në kostot e energjisë, ata mund të bëhen më të ndërgjegjshëm për mënyrën se si përdorin energjinë. Një përfshirje më e madhe në proces mund t'i ndihmojë ata të kontribuojnë në kursimin e energjisë dhe të zvogëlojnë shpenzimet e tyre.

Duke rritur përfshirjen e konsumatorëve dhe duke ofruar më shumë qartësi në raportet dhe konsultimet publike, procesi tarifor do të bëhet më transparent dhe më i drejtë, duke sjellë përfitime për të gjitha palët e përfshira. Kjo jo vetëm që do të ndihmojë në rritjen e besimit të institucionet, por do të sigurojë që tarifat të jenë të kuptueshme dhe të pranueshme nga publiku. Përfshirja aktive e konsumatorëve dhe zbatimi i një procesi të hapur do të kontribuojnë në një sistem më të qëndrueshëm dhe të balancuar, ku interesat e të gjithëve merren në konsideratë.



## RAPORT TEMATIK

TRANSPARENCA NË  
PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TË  
ENERGJISË ELEKTRIKE PËR  
PERIUDHËN 2021-2024

10/2024



British Embassy  
Pristina



Group for Legal  
and Political  
Studies

INSTITUTI GAP  
GAP INSTITUTE 

